



**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

**Kuvendi i Komunës Istog**

Skupština Opštine Istok  
Municipal Assembly Istog

Komititeti për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

8

**P r o c e s v e r b a l**

<b>Tipi i mbledhjes:</b>	Mbledhje e rregullt e KPF-së
<b>Data e mbajtjes:</b>	24.10.2018, në ora 10:00
<b>Mbledhjen e kryesoi:</b>	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
<b>Procesmbajtës:</b>	Vjosa Hysenaj, Zyrtare për punë të Kuvendit të Komunës.
<b>Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së</b>	Haki Podrimaj, Besa Ferati, Zenel Shatri, Eliot Kukiqi, Ardit Idrizaj, Ajshe Metaj.
<b>Mungojnë:</b>	
<b>Pjesëmarrës të tjera:</b>	Nënkyetari Lulzim Blakaj, Hazbi Bajra, Hysni Maxharraj, Isa Hoxha, Hazbi Bajra, Fitim Nuhiu dhe Hysena Pelaj OSBE, Lulzim Shoshi, Enver Rugova, Jeta Balaj,

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluar,
2. Shqyrtimi i raportit finansiar për tre mujorin e tretë (korrik - shtator) të vitit fiskal 2018,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit të Kryetarit për zvogëlimin dhe eliminimin e CO2-shit dhe preventivat për zvogëlimin e tije,
4. Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullores për tatimin në pronë,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitet.

**Diskutimet:**

Kryesuesi – z. Qaush Balaj - përshëndet Nënkyetarin z. Lulzim Blakaj, anëtaret e Komitetit për Politikë dhe Financa, Drejtoret, Zyrtar të Administratës Komunale, përfaqësues të OSBE, KFORI, mirë se keni ardhur ju faleminderit për pjesëmarrje.

Duke pasur parasysh se kuromi për mbajtjen e mbledhjes së Komitetit për Politikë e Financa është arritur me lejoni që të shpallë të hapura punimet e mbledhjes se Komitetit për Politikë e Financa.

Pyet nëse ka dikush ndonjë pyetje.

Nënkyetari i Komunës – përshëndet të gjithë të pranishmit, propozon një pikë të rendit të ditës: Miratimi i marrëveshjes për bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë.

Hedhe në votim Propozimin e Nënkyetarit Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë

Hedhe në votim Propozimin e Nënkyetarit Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë

Hedhe në votim rendin e ditës me këtë pikë të propozuara nga Nënkyetari.

**Konstatojmë se rendi i ditës miratohet një zërit, pa vërejtje me propozimin nënkyetarit**

**Vendimet:**

**Miratohet unanim rendi i ditës nga KPF-së pa vërejtje**

**Personat përgjegjës për zbatim:**

**Afati për zbatim:**

### **Shqyrtimi i pikës 1.**

**Diskutimet:**

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e parë të rendit të ditës, Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni. Pyete nëse dikush ka ndonjë pyetje apo diskutim rreth procesverbalit.

Pasi që nuk partë diskutime

Procesverbal hidhet në miratim:

**Vendimet:**

**Miratohet Procesverbali nga mbledhja e kaluar pa vërejtje,**

**Personat përgjegjës për zbatim:**

**Afati për zbatim:**

### **Shqyrtimi i pikës 2.**

**Diskutimet:**

Kryesuesi - vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e tretë (korrik - shtator) të vitit fiskal 2018.,

Osmon Sadikaj – zyrtar kryesor finaciar, përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e raportit financiar për tre mujorin e tretë (korrik - shtator) të vitit fiskal 2018.

Eliot Kukiqi, AAK - shpenzimet kapitale mbi 3 milion pse janë shpenzuar vetëm 5000 euro .

Nënkyetari i Komunës – Lulzim Blakaj – projektet janë në fazën e tenderimit.

Ajshe Metaj, PDK – projekti kanalizimi në fshatin Kamenicë ka pasur mjetet 50 mijë euro ndërsa tani i ka 38 mijë euro. Asfaltimi i rrugës Kamenicë – Orroberdë çka është në pyetje aty?

47118 paisja e shkollës me kabinet të biologjisë cila shkollë? Ndërtimi i shtëpisë 80 mijë euro?

Sanimi nga fatkeqësitë natyrore eliminimi i cilave fatkeqësi keni mëndu? 10 mijë euro teknologji informative. Rregullimi i atletikes në tre hapesh i pistës në shkollë a është profesional ky

projekt.

Nënkyetari i komunës – asfaltimet janë brenda fshatit Orroberdë dy rrugë.

Ajshe Metaj , PDK – rrugët në fshatin Orroberd 95 mijë euro,

Osmon Sadikaj – nuk jon 95 mijë euro po janë mbetje të projektit 0.95 cent. 47118 pajisjet e shkollës me kabinete të biologjisë dhe kimisë, drejtorati i arsimit e din cila shkollë i ka 9 mijë euro për këto kabinete.

Nënkyetari i Komunës – ndërtimi i shtëpive janë duke u ekzekutuar 8 familje i kemi përfitues. Sanimi nga fatkeqësitet natyrore nga era breshëri etj. Në teknologji janë 27 mijë euro tenderi është shpallur për kontraktuesin jemi në procedurë. Rregullimi i pistës 3 hapësh të atletikes kemi pasur komisionin profesional që e kanë pranuar punën, drejtori i shkollës dhe dy profesor të edukatës fizike.

Ajshe Metaj, PDK – aty janë jo profesional ata nxënës që ushtroj aty do të vrahën lëndohen ajo fusha është e marruar me kocka çimentos.

Nënkyetari i Komunës – aty ka pasur komision dhe aj komision është profesional ne nuk mund ta dimi se cili është mirë dhe jo mirë. Në fshatin Saradran janë kabinetet e kimis dhe të biologjisë.

Eliot Kukiqi, AAK – ndërtimi i rrugëve në fshatin Gurrakoc, cilat janë atë rrugë emrat ti kenë. Dhe rruga në Zhakovë lagja Idrizaj sa metra është e paraparë ajo rrugë të ndërtohet.

Jashar Blakaj – Drejtor – në Zhakovë është rruga ekzistuese 50 mijë euro nuk kanë mjaftuar me e përfunduar krejt rrugën 1520 m komisioni ka biseduar me ta dhe janë dakorduar që të përfundohet me mjete tjera, ky projekt mund të dështoj nëse marrëveshja nuk arrihet.

Ardita Idrizaj, AAK – në objektin e çerdhes në fshatin Vrellë ka mungesë të te shumë gjerave të ndihmohet.

Zenel Shatri, LDK – të gjitha çerdhet janë në gjendje të keqe të ngritën çmimet e pagesave përfëmije.

Nënkyetari i Komunës – tarifat i keni votuar vet në kuvend dhe i keni propozuar vet nuk mund të ngritën çmimet për shkak se janë të paraparë në Rregulloren komunale.

Edona Bujupi Loxha – Drejtoresh e Administratës – përshëndet të gjithë të pranishmit, pagesa e përfëmije në çerdhe ato mjete janë vetëm për ushqimin e atyre fëmijëve, ushqimi dhe kushtet e çdo çerdhe janë të mira, çdo drejtoresh e çerdheve e ka buxhetin e tyre të cilin duhet me menaxho për çka kanë nevojë.

Besa Ferati, LDK – QKMF- Istog nuk ka filma për fotografim.

Të gjitha këto fatkeqësit që po ndodhin në komunikacion a keni ndërmarr diçka?

**Vendimet:**

**Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime të tjera, KPF-ja vendosi:** që raporti finansiar për tre mujorin e tretë (korrik - shtator) të vitit fiskal 2018 i kalohet Kuvendit për shqyrtim.

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

**Shqyrtimi i pikës 3.**

**Diskutimet:**

Kryesuesi - po vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit të Kryetarit për zvogëlimin dhe eliminimin e CO2-shit dhe preventivat për zvogëlimin e tije.

Nënkyetari i Komunës – prezanton dhe sqaron Propozim – Vendimit të Kryetarit për zvogëlimin dhe eliminimin e CO2-shit dhe preventivat për zvogëlimin e tije.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, miratohet një zëri.

**Vendimet:**

**Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi:** që të miratohet Propozim – Vendimit të Kryetarit për zvogëlimin dhe eliminimin e CO2-shit dhe preventivat për zvogëlimin e tije, dhe e njëjtë i kalohet kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

**Shqyrtimi i pikës 4.**

**Diskutimet:**

Kryesuesi - po vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës, Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullores për tatimin në pronë,

Hysni Maxharri, Drejtor për Buxhet dhe Financa – bene prezantimin dhe sqarimin e Projekt- Rregullores për tatimin në pronë

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, miratohet një unanim.

**Vendimet:**

**Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi:** që të miratoj unanim Shpalljen në diskutim publik të Projekt Rregullores për tatimin në pronë, dhe të njëjtë i kalon kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

**Shqyrtimi i pikës 5.**

**Diskutimet:**

Kryesuesi - po vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës, Propozim-Vendimit për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë,

Nënëkryetari i Komunës -bene prezantimin dhe sqarimin e Propozim-Vendimit për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë,

Kryesuesi - pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, miratohet një zëri.

**Vendimet:**

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF - vendosi: që të miratoj një zëri Propozim-Vendimit për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë, dhe e njëjtë i kalon kuvendorit komunal për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendorit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendorit

**DISKUTIME**

Nënëkryetari i Komunës - përgjigjet znj. Besa për fatkeqshit e komunikacionit do ta kemi një rregullore të veqant.

Filmat e rengenit në QKMF- Istog, tenderi është fituar dhe nga operatori pritet që brenda kësaj jave të furnizoj me filma dhe gjera të nevojshme për rengen QKMF-në.

Kryesuesi - para mbylljes së mbledhjes konstaton kuorumin prezantë ishin të gjithë anëtarë e Komitetit për Politik e Financa, ju faleminderit për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë për këtë mbledhje.

Shpall të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj :

11:40